

BASHKIA MALËSI E MADHE
NJOFTIM PER MARRJE ME QIRA

Bashkia Malësi e Madhe kërkon të marrë me qira një objekt (Ndërtesë + tokë) me qira për stacionimin e automjeteve të Bashkisë, për depozitimin e druve dhe për zyrat Ndërmarrjes së Shfrytëzimit Pyjor.

Objekti i kërkuar duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

1. Sipërfaqja e nevojshme për parkimin e automjeteve të bashkise është 1000 m².
2. Sipërfaqja për venddepozitimin dhe përpunimin e druve është 1500 m².
3. Sipërfaqe ndërtesë të nevojshme për zyrë, 3 ambjente me sipërfaqe rreth 60 m².
4. Sipërfaqe ndërtesë të nevojshme për magazinimin, 3 ambjente me sipërfaqe rreth 300 m².
Sipërfaqe trualli totale 2500 m².
Sipërfaqe ndërtesë totale 360 m².
5. Të ketë furnizim me energji elektrike me 3 fazor, me kontratë të rregullt, ose të plotësojë kushtet për kontratë të re.
6. Distanca e ambjentit nga qendra e bashkisë mos të jetë më larg se 2 km vije ajrore.
7. Përbëjnë avantazh furnizimi me ujë, si dhe lidhja me afërt me infrastrukturen kryesore rrugore.
8. Sipërfaqja truallit dhe ndërtesës që do merren me qira duhet të jenë në funksion të njera-tjetrës.
9. Objekti duhet të jetë i pajisur me certifikate pronësie.

Dokumentacioni i ofertuesve që paraqiten për konkurim duhet të përbëhet nga:

- a. Kërkesa e subjektit për pjesëmarrje në konkurim.
- b. Deklaratë e hollësishme për funksionimin e objektit sipas destinacionit të kërkuar.
- c. Oferta për vlerën dhe detyrimin vjetor të qirasë (e ndarë edhe sipas muajve).
- d. Vërtetim që vërteton shlyerjen e të gjithave detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike.
- e. Mos shlyerja e energjisë elektrike përben shkak për skualifikimin e konkurruesit, pevec rastit ku rezultojnë se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike janë në proces ankimi në gjykatë.
- g. Vërtetim nga organet përkatëse që nuk është në ndjekje penale.
- h. Vërtetim që vërteton shlyerjen e taksave vendore.
- i. Dokumentat e kërkuar mësipër të jenë origjinale ose fotokopje të noterizuara, jo më parë se tre muaj nga data e hapjes së ofertave.
- j. Në ofertë duhet të deklarohet cmimi për meter katror (ku të përfshihet tatimi në burim).
- k. Dokumenti identifikimi i pronarit të objektit (pasaportë dhe /ose kartë identiteti ID).
- l. Vlera fillestare për konkurim: 1 270 000 (njemilionedytëdhjetemijë) leke/vit, sipas VKM-së 469 datë 03.06.2015. "Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore".

Ky dokumentacion të paraqitet në një zarf të mbyllur nënshkruar nga konkurruesi me mbishkrimin "Ofertë për dhënie me qira" dhe i dorëzohet Komisionit deri në orën e hapjes së konkurimit.

Mosparaqitja e njërit prej dokumentave të mësipërme përben kusht për skualifikim.

Vendi i zhvillimit të konkurimit :Bashkia Malësi e Madhe, Koplik Qendër, Malësi e Madhe . Ofertat dorëzohen nga të interesuarit/konkurentët fizikisht, me postë ose dorazi, në vendin e përcaktuar për zhvillimin e konkurimit.